



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 29 , Datë 26 / 03 /2021

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, PËRSA I PËRKET
LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR
RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUAR SI PASOJË E
DËMEVE SHKAKTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË
DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË
KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR.**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës, zëvendëskryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI**

1. Miratimin e ndryshimit të VKB nr.55, datë 26.06.2020, përrsa i përket listës emërore të familjeve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuar si pasojë e dëmeve shkaktuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar.
2. Heqjen nga lista e parë e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuar si pasojë e dëmeve shkaktuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 që i është bashkëlidhur VKB nr.55, datë 26.06.2020, për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar, të subjekteve si mëposhtë vijon:


NUMRI I APLIKIMIT	EMER	ATESI	MBIEMER	PALLATI
20840	ARANIT	FIQIRI	ZELA	KASTRATI
16788	ELIONA	KASTRIOT	CANI	KASTRATI
6423	ARIF	HAMID	SALLAKU	KASTRATI
21125	ADMIR	FATIT	HAXHIU	KASTRATI
28568	MUHBEDIN	BAJRAM	MYFTARALLARI	KASTRATI
40475	ARBER	SHEFQET	ÇYRBJA	KASTRATI
45059	ERSIOLA	XHAFERR	BILALI	KASTRATI
28367	MIMOZA	ZEQIR	DEMALIAJ	KASTRATI
14277	KUJTIM	SHEFQET	XHERAJ	KASTRATI
34168	ORJOLA	ILIA	BABA	KASTRATI
12062	ILIRJANA	METE	KIKRRI	KASTRATI
24191	MUHARREM	HASAN	GJYZELI	AHMET DAKLI 15

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinarë dhe Emergjencave Civile.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Dorina Milja

Me porosi dhe me mungese;
Almaida Proshani

U shpall sot më datë 01.04.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 246/1 prot.



Durrës, më 07.04.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 29 datë 26.03.2021 “Për miratimin e ndryshimit të VKB nr. 55 datë 26.06.2020, përsa i përket ndryshimit të listës emërore të familjeve përfutuese të Grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve shkaktuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

